

URDHËR
Nr. 253, datë 24.3.2026

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS SË PËRFAQËSIMIT LIGJOR TË
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME NË PROCESET
GJYQËSORE

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në ligjin nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të RSH-së”; në ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; në nenet 22 e vijuese të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për përfaqësimin ligjor të institucionit në proceset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjyimit dhe në Gjykatën Kushtetuese.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në proceset gjyqësore të nënshkruhen nga Sekretari i Përgjithshëm në emër të personit, apo personave që do përfaqësojnë institucionin.

3. Përfaqësuesi i autorizuar nga Sekretari i Përgjithshëm ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural të parashikuar nga legjislacioni në fuqi përpara gjykatave, prokurorisë, zyrave të përmbarimit gjyqësor, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit.

4. Të gjitha aktet e nënshkruara përpara hyrjes në fuqi të këtij urdhri dhe që janë nxjerrë në zbatim të urdhrit nr. 1091, datë 3.11.2025, “Për delegimin e kompetencës së përfaqësimit ligjor të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në proceset gjyqësore”, do të vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në përfundimin e procesit gjyqësor përkatës.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

6. Urdhri nr. 1091, datë 3.11.2025, “Për delegimin e përfaqësimit ligjor të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në proceset gjyqësore”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Ferit Hoxha